



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranverorë

Kryesia e Kuvendit
P-016
Prishtinë, më 22 prill 2008, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 22 PRILL 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Sllobodan Petroviq, Eqrem Kryeziu dhe Xhezair Murati;

Nga grupet parlamentare: Zylfi Merxha;
Munguan: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Bojan Stojanoviç.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca ;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI: Rinor Beka .

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur me 15 prill 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 29 prill 2008
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave
 - 3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa dhe i Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri lidhur me Raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit,
 - 3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa dhe i Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri për emërimin e tre anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit,
 - 3.3 Shqyrtimi i Propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës,
 - 3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për lejimin e kohëzgjatjes shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për Noterinë,
 - 3.5 Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me Projekt-Rregulloren e punës së komisioneve parlamentare,
 - 3.6 Shqyrtimi i kërkesës së Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për formimin e Panelit për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokatin e Popullit,
 - 3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për lejimin e udhëtimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë,
 - 3.8 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Lutfi Haziri për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belfast.

4. Të ndryshme:

- 4.1 Njoftimi me shkresën e Qeverisë lidhur me emërimin e Branisllav Grbiq, për zëvendësministër të Shëndetësisë,
- 4.2 Miratimi i vendimit për formimin e Komisionit intervistues, sipas konkursit të dt. 18 mars 2008.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të mbajtura më 15 prill 2008

Procesverbali i mbledhës së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 15 prill 2008 u miratuan pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të rendit të ditës, veç e veç.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e radhës të mbahet më 29 prill 2008, në orën 10:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 17 prill 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për taksën e vendosjes.
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të procedurës penale,
11. Shqyrtimi i propozimit të grupit Parlamentar të AKR-së për ndërrimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa dhe i Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri lidhur me Raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari informoi anëtarët e Kryesisë me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, të cilin e kishte e përkrahur në parim dhe i ka rekomanduar Kryesisë që të njëjtin t'a radhisë në rend dite të seancës së ardhshme, me kërkesë që drejtori i kësaj agjencie të raportoj para deputetëve të Kuvendit. Gjithashtu, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri i ka mbështetur plotësisht rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Sabri Hamiti propozoi që raporti i Agjencisë Kundër Korrupsionit të shqyrtohet në një seancë tjetër të radhës, me arsyetimin se për këtë seancë, e cila do të zgjatë një ditë, janë një numër i madh i projektligjeve për shqyrtim të dytë.

Kryesia njëzëri e miratoi propozimin e Sabri Hamitit dhe vendosi që shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, të shtyhet për një seancë tjetër.

3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa dhe i Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri për emërimin e tre anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari informoi anëtarët e Kryesisë me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, me të cilin ishte kërkuar nga grupet parlamentare që të propozojnë kandidatët për anëtarë në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, sipas praktikës dhe procedurave për nominimit dhe zgjedhjen e tre kandidatëve.

Gjithashtu, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri e ka mbështetur plotësisht rekomandimin e cekur më lart.

Kryesia, pasi e shqyrtoi rekomandimin, nxori këtë

P ë r f u n d i m

1. Kërkohe nga kryetarët e grupeve parlamentare të pozitës, që në afatin sa më të shkurtër, ta propozojnë nga një kandidat për anëtar në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit.
2. Kërkohe nga grupet parlamentare të opozitës që ta propozojnë një kandidat për anëtar në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

3.3 Shqyrtimi i Propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës

Kryetari informoi anëtarët e Kryesisë me propozimvendimin e Ministrisë, që ishte i mbështetur në nenet 6 dhe 7 të Ligjit për Provimin e Jurisprudencës për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Kryesia, pasi shqyrtoi propozim-vendim, nxori këtë

P ë r f u n d i m

1. Kërkohe nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta shqyrtojë Propozimvendimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin.
2. Rekomandimin nga paragrafi 1 i këtij përfundimi të paraqitet në afatin sa më të shkurtër.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me lejimin e kohëzgjatjes shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për Noterinë

Kryetari informoi anëtarët e Kryesisë me kërkesën e Komisionit të Legjislacion dhe Gjyqësi për lejimin e kohëzgjatjes shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për Noterinë.

Kryesia pasi shqyrtoi kërkesën e mësipërme, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohe kërkesa e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për Noteri.

3.5 Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me Projekt-Rregulloren e punës së komisioneve parlamentare

Kryetari informoi anëtarët e Kryesisë me rekomandimet e Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me vlerësimin e implikimeve buxhetore për Projekt-rregulloren e komisioneve parlamentare.

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimet e cekura më lart, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Kërkohej nga Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës që ta hartojë Projekt-rregulloren e Punës së Kuvendit, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pastaj të hartohen rregulloret e komisioneve parlamentare.

3.6 Shqyrtimi i kërkesës së Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për formimin e Panelit për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokatit të Popullit

Kryetari informoi anëtarët e Kryesisë me kërkesën s Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, me të cilën kërkohej që ky komision të jetë përgjegjës për formimin e Panelit intervistues për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokatin e Popullit.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në bazë të përgjegjësiqve që ka sipas Rregullave të procedurës së Kuvendit të për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, ka formuar Panelin Intervistues dhe ka filluar me punën për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për lejimin e udhëtimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë

Kryesia, pasi u informua me kërkesën e cekur më lart, nxori

P ë r f u n d i m

Kërkesa e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për lejimin e udhëtimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë nuk është në pajtim me Vendimin nr. 02-2242-1/06 për lejimin e udhëtimit jashtë vendit.

3.8 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Lutfi Haziri për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belfast

Kryesia, pasi u informua me kërkesën e deputetit Lutfi Haziri, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Kërkesa e deputetit Lutfi Haziri për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belfast nuk është në pajtim me Vendimin nr. 02-2242-1/06 për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit.

4. Të ndryshme:

4.1 Njoftimi me shkresën e Qeverisë lidhur me emërimin e Branislav Grbiq, për zëvendësministër të Shëndetësisë,

Kryesia u njoftua se Qeveria ka emëruar z. Branislav Grbiq, për zv.ministër të Shëndetësisë.

4.3 Miratimi i vendimit për formimin e Komisionit intervistues, sipas konkursit të dt. 18 mars 2008

Kryesia, pasi shqyrtoi Propozimvendimin për formimin e Komisionit intervistues, mori këtë

V E N D I M

I. Formohet Komisioni intervistues për përzgjedhjen e kandidatëve për të gjitha pozitat e shpallura sipas konkursit të datës 18 mars 2008, në këtë përbërje:

1. Ismet Krasniqi, kryesues i Komisionit,
2. Isa Neziri, anëtar,
3. Daut Beqiri, anëtar,
4. Natasha Prica- Tishma, anëtare dhe
5. Nexhat Jashari, anëtar.

II. Komisioni ka për detyrë që të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve për të gjitha pozitat e shpallura sipas konkursit të datës 18 mars 2008.

III. Ngarkohet Departamenti i Administratës së Kuvendit, që të zbatojë këtë vendim.

4.4 Shqyrtimi i kërkesës së stafit të Administratës së Kuvendit për udhëtim në Shqipëri

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V e n d i m

1. Lejohet udhëtimi studimor i stafit të Administratës së Kuvendit në Republikën e Shqipërisë prej 30 prillit deri më 4 maj 2008.
2. Shpenzimet e udhëtimit i përballon buxheti i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale